



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.552/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Shukri Rudi me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga Shukri Rudi, Zarife Rudi, Qëndresë Rudi, Zahrije Rudi, Diellzë Rudi, Egzon Rudi dhe Fatbardha Rudi me vendbanim në Gjermani, i paraqitur kundër KQZ-se për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, Urdhërohet KQZ-ja, të përfshijë apeluesit në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 29.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Shukri Rudi me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se anëtarët e familjes së tij kanë mbushur formularët e regjistrimit për votim me post me datën 17.08.2021 duke ja bashkangjitur edhe dokumentet e tyre. Parashtruesi i apelit thekson se përveq konfirmimit automatik nuk kanë marr asnjë njoftim dhe asnjë anetar i familjes së tij nuk gjendet në listën e votuesve me post, pasi që të gjithë anëtarët e familjes kanë aplikuar si bashkësi.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur imazhe të dokumenteve identifikuese-pasaportave dhe formularëve si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit, e që janë pasaportat valide të Republikës së Kosovës, janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se Shukri Rudi, Zarife Rudi, Qëndresë Rudi, Zahrije Rudi, Diellzë Rudi, Egzon Rudi dhe Fatbardha Rudi, në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotësojnë kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 552/2021 më datën 31.08.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.